


ISSN 1857 - 8896



# ANAS

Studia humanitatis

# 13

Botimi i kësaj reviste është mbështetur nga:



Ministria e Kulturës e Republikës së Maqedonisë

Shkup, 2018

# NS

## Studia humanitatis

# 13

Botues  
Instituti Alb-Shkenca

Editor  
Alb-Shkenca Institut

Redaktori përgjegjës  
Prof. dr. Zeqirja NEZIRI  
"Shën Cirili dhe Metodi", Maqedoni

Editor-in-chief  
Zeqirja NEZIRI, PhD., University  
"St. Cyril and Metodij", Macedonia

Zëvendës redaktorë  
Prof. dr. Shpresa HOXHA  
(Universiteti i Prishtinës, Kosovë)  
Prof. dr. Kristaq JORGO  
(Universiteti i Tiranës, Shqipëri)

Vice editors  
Shpresa HOXHA, PhD  
(University of Pristina, Kosovo)  
Kristaq JORGO, PhD  
(University of Tirana, Albania)

Redaksia  
(Shqipëri) Emil LAFE  
(SHBA) Sami REPISHTI  
(SHBA) Niko QAFOKU  
(Maqedoni) Zeqirja NEZIRI  
(Kosovë) Shpresa HOXHA  
(Shqipëri) Kristaq JORGO  
(Maqedoni) Mustafa IBRAHIMI  
(Shqipëri) Lluka QAFOKU  
(SHBA) Robert MAGARI  
(Kosovë) Arbnora DUSHI  
(Kosovë) Nebi CAKA  
(Shqipëri) Merita SAUKU BRUCI  
(Maqedoni) Agim LEKA  
(Kosovë) Arben HOXHA

Editorial board:  
Emil LAFE (Albania) ✓  
Sami REPISHTI (USA) ✓  
Niko QAFOKU (USA)  
Zeqirja NEZIRI (Macedonia) ✓  
Shpresa HOXHA (Kosovo) ✓  
Kristaq JORGO (Albania)  
Mustafa IBRAHIMI (Macedonia)  
Lluka Qafoku (Albania)  
Robert MAGARI (USA)  
Arbnora DUSHI (Kosovo)  
Nebi CAKA (Kosovo)  
Merita SAUKU BRUCI (Albania)  
Agim LEKA (Macedonia)  
Arben HOXHA (Kosovo)

Redaktor teknik  
Prof. dr. Mustafa IBRAHIMI

Technical editors  
Mustafa IBRAHIMI, PhD.

## PRMBAJTJA

ZEQIRJA NEZIRI.....	5
<b>PROCESI I GLOBALIZMIT DHE STUDIMET HISTORIKE LETRARE SHQIPTARE .....</b>	<b>5</b>
<b>THE PROCESS OF GLOBALIZATION AND HISTORICAL STUDIES OF ALBANIAN LITERATURE .....</b>	<b>5</b>
MUSTAFA IBRAHIMI.....	21
<b>IDENTITETI ARBËRESH PËRBALLË GLOBALIZMIT .....</b>	<b>21</b>
<b>“ARBËRESH” IDENTITY VERSUS GLOBALIZATION .....</b>	<b>21</b>
LIRIM SULKO .....	29
<b>ANALOGY, AS FORM OF FUNCTION IN THE NOVEL "PALACE OF DREAM" .....</b>	<b>29</b>
<b>ANALOGJIA, FORMË E FUNKSIONIMIT NË ROMANIN "PALLATI I ËNDRRAVE" .....</b>	<b>29</b>
MIRELA PAPA.....	37
<b>THE DICTIONARY AND TRANSLATION.....</b>	<b>37</b>
<b>FJALORI DHE PËRKTHIMI.....</b>	<b>37</b>
KOSOVARE KRASNIQI.....	51
<b>KOSOVA NË POEZINË E RILINDJES KOMBËTARE.....</b>	<b>51</b>
<b>KOSOVO IN THE POETRY OF NATIONAL RENAISSANCE.....</b>	<b>51</b>
GANI PLLANA .....	59
<b>HARTIMI I FJALORËVE TË TERMAVE BAZË TEKNIKË (MEKANIKË, NDËRTIM, ELEKTRIKË).....</b>	<b>59</b>
<b>THE DRAFTING OF DICTIONARIES OF BASIC TECHNICAL TERMS (MECHANICS, CIVIL ENGINEERING, ELECTRICAL).....</b>	<b>59</b>

---

BADE BAJRAMI.....	73
KUR TERMAT GJUHËSORË NUK PËRKOJNË .....	73
WHEN THE LINGUISTIC TERMS DO NOT COINCIDE .....	73
<u>FARKETA DIBRA - ZEQIRI</u> .....	81
LEXIMI – NJË MISION I RËNDËSISHËM I BOTËS BASHKËKOHORE.....	81
READING- AN IMPORTANT MISSION OF THE CONTEMPORARY WORLD .....	81
NELI NAÇO .....	91
CULTURAL MEMORY IN MITRUSH KUTELI'S STORIES.....	91
MEMORJA KULTURORE NË RRËFIMET E MITRUSH KUTELIT .....	91
BUHARAJA EDMOND .....	99
DIASPORA MUZIKORE ARBËRE PËRGJATË HUMANIZMIT .....	99
MUSICAL ARBËR DIASPORA DURING HUMANISM.....	99

**ANS**

Nr. 13, Shkup 2018

ISSN 1857-8896

UDC \_028.5-057.874(497.7)

Punim studimor

**FARKETA DIBRA - ZEQRIRI**

Katedra e Gjuhës dhe e Letërsisë Shqiptare  
Fakulteti i Filologjisë "Bllazhe Koneski"  
Universiteti "Shën Cirili e Metodi" Shkup, MAQEDONI  
Email: farketadibra@gmail.com

**LEXIMI - NJË MISION I RËNDËSISHËM I BOTËS  
BASHKËKOHORE****READING- AN IMPORTANT MISSION OF THE  
CONTEMPORARY WORLD****Përmbledhje**

Në këtë punim jemi marrë me studimin e interesimit të nxënësve të shkollave të mesme në Maqedoni lidhur me leximin si një mision i rëndësishëm, i cili ndikon në ngritjen dhe zhvillimin e personalitetit të çdo individi. Kampioni i përfshirë në anketim përbëhet nga 1.485 nxënës të shkollave dhe qyteve të ndryshme të Maqedonisë. Përmes pyetësorit bëhet identifikimi i mbarëvajtjes së orëve të

lektyrës, meqenëse brenda kësaj ore shihet më qartë niveli i leximit të nxënësve dhe motivimi për lexim. Në bazë të rezultateve konstatuam se nxënësit lexojnë shumë pak dhe jo vazhdimisht, por vetëm në rast nevojë, madje edhe atëherë nuk përmbushen zbrastirat e parapara. Kjo gjendje është rrjedhojë e disa faktorëve, ndër të tjera veçanësisht: titujt e veprave janë jo në hap me kohën duhen ndryshuar; duhet të mbahet llogari

për sasinë e veprave voluminoze; në të shumtën e rasteve mungon motivimi nga ana e mësimeve, prindërve.

**Fjalët çelës:** leximi, lektyra, nxënësi, mësimeve, shkolla.

### Summary

In this paperwork, as an aim we have set ourselves to prove the high school student's interest in Macedonia related to the reading, as an important mission which affects on increasing and developing of the each individual's personality. The sample included in the questionnaire consists of 1.485 students of the different schools of Macedonia.

The questionnaire aims to identify the progress of the lesson about the reading materials, because within this lesson we can clearly see the level that how much the students have read, how motivated they are to read. Based on the results we concluded that we belong to a nation which reads less and not continuously but only when needed. This condition is the result of several factors among others we underlined that: the work's titles are not up to date, they must be amended; we must keep account of the voluminous amount of works.

**Key words:** reading, reading materials, teacher, school.

### Hyrje

Në ditët e sotme libri paraqet pjesë të përditshmërisë së secilit nxënës. Shoqërimi dhe kontakti i përditshëm me të zë një vend të rëndësishëm në angazhimet e tij shkollore dhe nga koha e lirë. Libri lexohet, tregohet dhe përjetohet, ai na informon, paralajmëron, sugjeron, i jep kuptim jetës, me një fjalë – edukon.

Shoqëria e sotme me një brez të mirë rinie të shkolluar, me pretendime socio-kulturore të larta e ka të nevojshme qenësinë pranë librit, jo si dekoracion, por si vërtetësi, si nevojë, domosdo për të mësuar dhe ecur përpara. Meqenëse, cilësi e natyrës së njeriut është t'i njohë gjerat, t'i kuptojë, interpretojë, analizojë, diskutojë për to, atëherë çdo njeri duhet të kalojë nëpër këto faza me qëllim që të plotësohen standardet e kërkuara për të qenë në hap me kërkesat e kohës si mendimtarë kritikë dhe të aftë për të fituar shkathtësitë e shekullit XXI, kërkesë e së cilës është edhe vetë leximi.

"Paralelisht me të folurit, të shkruarit dhe të dëgjuarit, të lexuarit është një aktivitet mjaft i rëndësishëm, burim kryesor njohurish, mjet ndërlidhjeje dhe komunikimi. Konsiderohet si proces i rëndësishëm intelektual dhe edukativ, i cili mundëson realizimin e shumë marrëdhënieve komunikative mes njerëzve. Shkolla, si institucion përmes së cilës përcillen dhe përvetësohen dijet, e sheh të lexuarin si çelësin e

sukseseve të çdo individi në të gjitha moshat e edukimit të tij" (Gjokutaj, 2012: 201).

Studiuesit amerikanë: *Anderson, Hieberti, Skoti dhe Wilkinson* theksojnë se: "të lexuarit është aftësi jetësore bazë. Ai është gur themeli për suksesin e fëmijës në shkollë e madje edhe gjatë gjithë jetës. Pa pasur aftësinë për të lexuar mirë, mundësitë për realizimin e vetvetes dhe për arritjen e suksesit profesional, pa dyshim që do të humbasin. Ky ndikim në jetën e secilit prej nesh i bën shumë studiues që ta quajnë leximin si një e drejtë themelore e njeriut. Është vështirë të përfytyrohet një aftësi tjetër që ta ilustrojë më mirë qëllimin e shkollimit" (Gjokutaj, 2012 : 212).

Edhe përkundër një vlere jashtëzakonisht të madhe që ka leximi, kohëve të fundit gjithnjë e më tepër qarkullojnë zëra jo vetëm nga njerëzit e rëndomtë, por edhe nga studiues, metodistë, analistë, mësues të gjuhës dhe letërsisë shqipe të cilët shprehin dëshpërimin e tyre, duke pohuar se ka humbur vlera dhe rëndësia e librit, kemi krizë leximi, të rinjtë gjithnjë e më pak lexojnë..... e kështu me radhë. Bazuar nga ky fakt, në këtë kumtesë do të trajtojmë interesimin e nxënësve të shkollave të mesme në Maqedoni lidhur me leximin si mision i rëndësishëm i cili ndikon në ngritjen dhe zhvillimin intelektual të individit në përgjithësi.

Lënda e gjuhës dhe letërsisë shqipe i detyron nxënësit të lexojnë një numër të caktuar veprash letrare të parapara sipas plan-programit mësimor të emërtuara si *lektyra*. Pikërisht, për këtë arsye themi se mësimi i lëndës së gjuhës dhe letërsisë shqipe e ka mundësinë më të madhe që ta nxisë nxënësin të lexojë.

Për të pasur një pasqyrë më të qartë se në çfarë gjendje është rinia e sotme sa i përket leximit si faktor që ndikon në ngritjen dhe zhvillimin e personalitetit të çdo individi është e palogjikshme të flasim dhe hamendemi pa i mbështetur mendimet dhe idetë tona në fakte reale, prandaj vendosëm që këtë çështje ta hulumtojmë praktikisht përmes një pyetësoi.

Tematika e pyetjeve në pyetësor ka të bëjë me organizimin, mbarëvajtjen dhe përpunimit e orës së lektyrës, meqenëse, pikërisht brenda kësaj ore shihet më qartë se kudo tjetër interesimi i nxënësit për lexim, gjithashtu nxirren në pah edhe faktorët që ndikojnë në largimin e nxënësit nga leximi i veprave të caktuara (Dibra-Zeqiri, 2011: 108).

### **Instrumentet e kryerjes së studimit**

Si instrumente të anketimit përgatitëm një pyetësor, i cili u plotësua individualisht me shkrim nga vetë nxënësit pas shpjegimit që dhamë për secilën pyetje në veçanti.

➤ Kampioni i përfshirë në anketim përbëhet nga 1.485 nxënës të shkollave të mesme të Maqedonë, prej vitit të parë e deri në vitin e katërt.

➤ Përzgjedhja e nxënësve nuk ishte rastësishme: u përpoqëm të përfshijmë nxënës të tre niveleve, duke filluar nga ai i ulët, i mesëm dhe i lartë, me qëllim që të kemi rezultate sa më të sakta.

➤ Shkollat që iu nënshtruan anketimit ishin: "Zef Lush Marku"-Shkup, "Arseni Jovkov"-Shkup, "Cvetan Dimov" -Shkup, "Pançe Karagjov"-Shkup, "Kiril Pejçinoviç"-Tetovë, "7 Marsi"- Tetovë, "Gostivari"-Gostivar, "Drita" -Kërçovë, "Ibrahim Temo"-Strugë, "Niko Nestor"-Strugë, "Sami Frashëri"-Kumanovë.

➤ Pyetjet në pyetësor janë strukturuar në atë mënyrë që të ketë alternativa edhe pyetje të hapura me qëllim që nxënësit t'i shprehin më lirshëm mendimet, vlerësimet, komentet dhe rekomandimet rreth temës në fjalë.

➤ Pyetësi iu nënshtrua një analize statistikore dhe përmbajtjesore, që na shërbeu si bazë në paraqitjen e konkluzioneve.

Për të parë në mënyrë statistikore rezultatet e këtij hulumtimi, do të japim disa pyetje nga pyetësi, të cilat lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me tematikën e punimit. Një nga pyetjet e përzgjedhura mes tjerash thotë:

### 1. Nga sa lektyra punoni në muaj?




Figura 1

Nëse i hedhim një sy kurrikulës së gjuhës amtare për shkollë të mesme, vërejmë se lektyra është e paraparë si fushë e detyrueshme për t'u punuar me nga një vepër brenda çdo muaji. Prandaj, me plot të drejtë një mesatare e mirë e nxënësve të anketuar, pra 88% prej tyre janë përgjigjur se punojnë nga një lektyrë në muaj, ndërsa mesatarja tjetër prej 12% janë përgjigjur se punojnë nga dy lektyra në muaj. Mesataren prej 12% nuk mund ta vlerësojmë si të gabuar, përkundrazi e lidhim me faktin se përveç lektyrave, si vepra të detyruara nxënësit me detyrë të mësimdhënësit mund të lexojnë edhe vepra të tjera shtesë nga plan-programi mësimor të parapara për atë vit shkollor. Megjithatë, ekziston edhe një mundësi tjetër

që pak më rrallë ndodhë te ne, ku një numër i vogël nxënësish kanë dëshirë të lexojnë më shumë dhe duan që nga çdo shkrimtar të lexojnë disa vepra të tij, që paraprakisht të jenë të përgatitur për provimin e pjekurisë në përfundim të vitit të katërt, ky fakt sjell rritje të numrit të përgjithshëm të veprave të lexuara brenda çdo muaji. Këto janë disa nga arsyet që na shtojnë të mendojmë se pse 12% e nxënësve janë shprehur se lexojnë/punojnë nga dy lektyra në muaj.

### 2. A i keni lexuar lektyrat gjatë këtij viti shkollor?




Figura 2

Rezultatet e kësaj pyetje konstatojnë një gjendje jo të lakmueshme, e cila lë shumë për të dëshiruar, meqenëse nga 1.485 nxënës të anketuar vetëm 25% prej tyre i kanë lexuar të gjitha veprat e parapara si lektyra për vitin shkollor; 36% e nxënësve janë përgjigjur se nuk kanë lexuar asnjë vepër, ndërsa 39% e nxënësve të anketuar janë përgjigjur se kanë lexuar vetëm disa vepra.

Nga kjo mesatare shohim se vetëm 25% e nxënësve mund të themi se janë lexues të rregullt, që si mesatare është e ulët përkundrejt faktit se 39% prej tyre nuk kanë lexuar asnjë vepër të paraparë nga lista e lektyrave.

### 3. Përveç lektyrave që jeni të detyruar t'i lexoni, a lexoni vepra të tjera për kërsërinë tuaj estetike?




Figura 3

Nga rezultatet e pyetjes paraprahe u pa sheshit se puna me leximin e lektyrave në shkollat tona është mjaft e mangët. Pra, nëse ekziston mosinteresimi për diçka të detyrueshme siç është lektyra shkollore, atëherë është absurde të mendojmë që nxënësit do të lexojnë në masë të madhe vepra të tjera për të përmbushur kënaqësinë e tyre. Se deri në ç'masë nxënësit lexojnë vepra për ta përmbushur këtë kënaqësi flet grafiku ku: 79% e të anketuarve janë shprehur se përveç lektyrave shkollore, nuk lexojnë vepra të tjera, ndërsa 21% e të anketuarve janë përgjigjur se lexojnë vepra të tjera për kënaqësinë e tyre estetike dhe atë: 17% prej tyre lexojnë nga një vepër në muaj, ndërsa 4% nga dy vepra në muaj.

Është fakt për t'u gëzuar kur shohim se një pjesë e vogël nxënësish shprehin dëshirë dhe interesim për të lexuar, pra lexojnë pa i detyruar, mirëpo kjo nuk është e kënaqshme dhe nuk mjafton përkundrejt përqindjes së përgjithshme të nxënësve, sepse kemi një përqindje shumë të lartë nxënësish që nuk lexojnë asnjë vepër të detyrueshme, kjo bën që të humbasë efektin dhe vlerën edhe ajo përqindje nxënësish, që lexojnë në sasi më të madhe.

#### ***4. Kur mendoni se keni lexuar më shumë lektyra, në shkollë fillore apo tani në të mesme?***

Lektyra është integruar në leximin letrar në të gjitha fazat e shkollimit, si në atë fillor, ashtu edhe në atë të mesëm. Kjo do të thotë se leximi i pavarur i tekstit beletristik fillon sistematikisht që nga shkolla fillore dhe i përshtatet moshës së nxënësve deri në përfundim të shkollimit të mesëm. Se cilën fazë të jetës së tyre do ta marrin nxënësit si më produktive gjatë zhvillimit të tyre, kjo varet nga puna dhe angazhimi i mësuesit. Nga rezultatet e pyetjes në fjalë 35% e nxënësve të anketuar mendojnë se në shkollë fillore kanë qenë më pak të angazhuar dhe kanë lexuar më pak lektyra në krahasim me periudhën e tanishme që janë në shkollë të mesme, ndërsa 65% e të anketuarve mendojnë se tani janë më të angazhuar sa i përket punës së leximit të lektyrave.

#### ***5. A përputhet tematika e veprave me interesimin tuaj?***

Në këtë pyetje hasëm në përgjigje të ndryshme. Mes tjerash nxënësit pohuan se tematika e veprave të parapara për t'u punuar gjatë katër viteve të shkollimit të mesëm nuk përputhet me interesimin dhe kërkesat e tyre. Titujt e veprave u duken të vjetruar dhe nuk arrijnë të trokasin në zgjimin e kureshtjes dhe interesimin e botës së tyre; nuk është i njëjtë interesimi